

VENDIM
Nr.828, datë 10.12.2004

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.675, DATË 20.12.2002 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRDORIMIN E FONDEVE BUXHETORE, TË PLANIFIKUARA PËR
MALLRAT, SHËRBIMET DHE NDËRTIMET”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimein publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Shtetit për Koordinimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pas pikës 6.2/1 të vendimit nr.675, datë 20.12.2002 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të shtohet pika 6.2/2 me këtë përmbajtje:

“6.2/2. Përgjashtimisht rregullave të përcaktuara në pikën 6.2 shkollat e larta dhe fakultetet për plotësimin e nevojave të tyre për mallra, shërbime e ndërtime, lejohen që për fondet e tyre buxhetore, të miratuara apo ato të krijuara, t’i kryejnë vetë procedurat e prokurimit, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano